



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:156044

Datë: 15.10.2021

Numri i dokumentit: 02283584

P.nr.1018/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Refki Piraj, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.1575-5/20 të dt. 11.11.2020, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 14.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.R., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me dt., në Prizren, ku edhe banon në rrugën ‘.....’, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal,

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 04.04.2020 rreth orës 16:15 në Prizren në rrugën ‘.....’ afër QKMF-së në Prizren, i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit V.J., të përshkruara më saktësisht si në akt ekspertizën mjeko ligjore të Dr. D.H., të datës 09.10.2020, të vilat si të tilla paraqesin dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykatë në kuptim të nenit 495 të Kodit të Procedurës penale jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.1575-5/20 të dt. 11.11.2020.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 4, 7, 17, 43, 46, dhe nenit 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej njëqindekatër dhjetë (140) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari F.R., nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë në shumë prej njëqindekatër dhjetë (140) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë në lartësi prej njëqindekatër dhjetë (140) euro, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo (20) € llogaritet një (1) ditë burg, respektivisht shtatë (7) ditë burgim.

I akuzuari obligohet që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej njëzetë (20) €, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) €, të gjitha këto në afat prej (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari **V.J.**, nga Prizreni me banim në rrugën '.....' nr...., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1575-5/20 të dt. 11.11.2020, kundër të pandehurit F.R., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënime me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit te shkresave te lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari i lëndës ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 p.1 te KPPK-se, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPPK-së vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit 2020-GA-0490 i datës 4.04.2020. Raporti i Oficerit me numër të rastit 2020-GA-0490 i datës 04.04.2020.

Deklarata e të dëmtuarit V.J., dhënë në Stacionin Policor me datë 04.04.2020.

Deklarata e të pandehurit F.R., dhënë në Stacionin Policor me datë 04.04.2020.

Akt ekspertiza mjeko ligjore me Dr. D.H., të datës 09.10.2020.

Foto dokumentacioni si dhe i shkresave tjera të lëndës, dhe u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë vepër penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Me sa u tha me lartë, në kuptim te nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1018/20 me datë 14.10.2021**

Praktikanti
Rrahim Sallauka

G j y q t a r i
Refki Piraj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në këtë gjykatë. Po që se i pandehuri nuk paraqet kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.